

KONSOLIDIMI MAKROEKONOMIK :
ARRITJE DHE SFIDA

Dhori Kule

Dekan, Universiteti i Tiranës

Sulo Hadëri

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së

Shqipërisë

ABSTRAKT

Në këtë kumtesë analizohet procesi i stabilizimit makroekonomik gjatë periudhës së tranzicionit dhe i suksesit të arritur nga Shqipëria në uljen e kontrollin e inflacionit, në ritmet relativisht të larta të rritjes, në uljen graduale të deficitit buxhetor dhe stabilitetin relativ të kurseve të këmbimit. Në këtë aspekt, ne analizojmë rolin e politikave monetare, fiskale, të variablave të jashtëm, të reformave strukturore dhe të atyre institucionale dhe të faktorit të jashtëm si IMF në arritjen dhe qëndrueshmërinë e stabilizimit makroekonomik.

Konkluzioni kryesor është se sukcesi i arritur është kryesisht rrjedhojë e zbatimit të politikave të matura monetare e fiskale dhe e reformave relativisht të shpejta e të gjera strukturore. Stabiliteti makroekonomik që i kontribuon rritjes, e cila e bën atë të

qëndrueshëm nuk mund të ruhet pa stabilitetin politik dhe pa një rritje të qëndrueshme ekonomike afatgjatë.

I. HYRJE

Lëvizja e një vendi nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu ndeshet me një varg problemesh madhore ku përballimi i inflacionit dhe sigurimi i ritmeve të qëndrueshme të rritjes ekonomike, përbëjnë kushtin bazë të një kalimi të suksesshëm.

Gjatë 10 viteve të tranzicionit, Shqipëria ka shënuar një progres të dukshëm në drejtim të qëndrueshmërisë makroekonomike të zbatimit të reformave të thella strukturore; në drejtim të privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mëdha, të institucioneve financiare e të shërbimeve publike, të liberalizimit të tregtisë së jashtme, të forcimit të rendit, të sigurisë dhe të reformimit institucional. Veçanërisht në stabilizimin makroekonomik Shqipëria konsiderohet e suksesshme³².

Përkundrejt kushteve të pafavorshme të nisjes (shih tabelën 1) dhe të nivelit të ulët të produktit për frymë, janë ruajtur ritme relativisht të larta rritjeje ekonomike. Inflacioni i lartë në fillimet e tranzicionit si pasojë e reformave strukturore, por edhe për shkak të tronditjeve të brendshme (1991-1992 dhe 1997) jo vetëm që ka ardhur duke u ulur, por përgjithësisht, është mbajtur nën kontroll duke arritur nivele negative dhe për vitin në nivele të moderuara, në përputhje me objektivat e vendosur, në 4.2 për qind.

Megjithë arritjet e dukshme, ekonomia shqiptare vazhdon të jetë relativisht e dobët, me stabilizim të brishtë makroekonomik, me çbalancime të jashtme dhe fiskale, me të ardhura për frymë nga më të ulëtat në Europë, me varfëri relativisht të lartë dhe me institucione relativisht të dobëta. Konsolidimi makroekonomik është i brishtë, ai mund të prishet aq shpejt sa vendoset (viti 1997), bilanci tregtar është i çbalancuar, deficitit buxhetor dhe borxhi në nivele të konsiderueshme (tabela 3), tregu financiar vazhdon të jetë në nivel të ulët zhvillimi etj..

Në të ardhmen e afërt dhe më të largët ngelen sfida të rëndësishme për t'u përballuar që lidhen me konsolidimin fiskal; me konsolidimin e reformave në sistemin bankar dhe me krijimin e tregut të kapitalit; me përfundimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve industriale, të shërbimeve publike dhe të

³² Shih World Bank (1998, 2001), IMF (1995).

institucioneve financiare të zotëruara nga shteti; me thellimin e institucionalizimit të tregut, përfshirë konsolidimin e të drejtave të pronësisë, nxitjen e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorit; me thellimin e reformimit dhe të modernizimit të institucioneve shtetërore, në përputhje me standardet e demokracisë dhe të tregut.

II. VËSHTRIM HISTORIK I PRAGTRANZICIONIT

Në literaturën e pakët botërore rreth Shqipërisë së paratranzicionit ajo konsiderohej si vendi më i varfër i Europës³³. E vendosur në një pozicion mjaft të favorshëm gjeografik dhe me një histori të gjatë pushtimesh nga të huajt, çka do të thotë vendi i fundit evropian që u shpall i pavarur, për fatin e keq të rradhës, mbas Luftës së Dytë Botërore ajo hyri në rrugën komuniste të zhvillimit. Nga kjo pikëpamje, fillimi i tranzicionit e gjeti Shqipërinë si një vend komunist me tipare të ngjashme me vendet e bllokut lindor, të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik dhe veçanërisht, me vendet komuniste që sot njihen si vendet e Europës Juglindore.

Megjithatë, Shqipëria shfaqti edhe veçori të theksuara që e dallojnë atë nga vendet e tjera ish-komuniste.³⁴ Ajo ishte vendi më pak i përgatitur nga pikëpamja ekonomike, politike, sociale dhe kulturore për të ndërmarrë reforma rrënjësore drejt ekonomisë së tregut. Shqipëria, ishte i vetmi vend evropian i bllokut komunist, që nuk kishte ndërmarrë asnjë reformë të rëndësishme ekonomike dhe politike, që i jepte frymëmarrje ekonomisë si, decentralizimi i vendimmarrjes, rritja e rolit të tregut apo demokratizimi i vendit. Modeli që ajo zbatoi gjatë 45 vjetëve mbështetej në zbatimin rigoroz të ideologjisë marksiste dhe të praktikave staliniste.

Në rrafshin ekonomik, modeli shqiptar karakterizohej nga eliminimi i të gjitha formave të pronës private nëpërmjet shtetëzimit të plotë të industrisë dhe të kolektivizimit të bujqësisë;³⁵ nga mbështetja e plotë në planifikim dhe drejtimin e centralizuar duke mos lënë, pothuajse asnjë rol, për shpërndarjen e burimeve nga tregu³⁶ dhe;

³³ Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore PBB për frymë në vitin 1991 ishte 340 usd.

³⁴ Për një trajtim më të hollësishm shih IMF (1992), Aslund & Sojberg (1992), Pashko (1994), Muço 1997, Hadëri et al.(1999).

³⁵ Madje në vitet '80 edhe prona e vogël private në bujqësi e njohur si "oborri kooperativist" apo "prona personale" u eliminua pothuajse plotësisht.

³⁶ Vendet e tjera komuniste ndërmorën reforma të ndryshme që synonin një rol më të madh të tregut si në Hungari dhe Jugosllavi dhe një decentralizim të vendimmarrjes në rang ndërmarrjeje, në BS dhe vende të tjera.

nga zbatimi ekstrem i parimit të mbështetjes në forcat e veta dhe të pavarësisë ekonomike.³⁷

Në rrafshin politik, modeli shqiptar karakterizohej nga një mungesë pothuajse e plotë e traditës demokratike³⁸ dhe nga zbatimi ekstrem i parimit të luftës së klasave, i cili i ruan pasojat edhe në vitet e tranzicionit.

Ekonomia shqiptare, e mbështetur edhe nga faktorë të jashtëm, shfaqti shenja rritjeje deri në fundin e viteve '70³⁹, ndërsa vihet re një përkeqësim i ndjeshëm, veçanërisht në gjysmën e dytë të viteve '80. Kjo periudhë, shoqërohet me rritje të punësimit të pashoqëruar me rritjen e investimeve kapitale, me një përkeqësim të ndjeshëm të bilancit të pagesave, me shterim të rezervave valutore, me rritje të borxheve të jashtme, me përkeqësim të eksporteve dhe me krijim të mungesave të mallrave të konsumit.

Megjithëse niveli i çmimeve ishte i pandryshuar, të dhënat flasin për një inflacion latent, i cili u përshpejtua në fund të periudhës (shih Pashko, 1993). Fundi i regjimit komunist dhe fillimi i tranzicionit⁴⁰ e gjeti Shqipërinë me probleme të akumuluarra strukturore, me politika të pamënaxhuara drejt, me çbalancime fiskale e të jashtme dhe me mungesë vullneti politik për të ndërmarrë reformat që kishin filluar në vendet e tjera komuniste.⁴¹

Sidoqoftë, në literaturën e shumtë të studimeve rreth tranzicionit sipas kriterit gjeografik, fillimit të tranzicionit, të ecurisë dhe arritjeve makroekonomike, nivelit të reformave, të shpejtësisë e të vijueshmërisë së reformave, Shqipëria klasifikohet në grupin e gjerë të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, duke e veçuar në nëngrupin e vendeve të quajtura “reformues të vonshëm” ose, në disa raste, në grupin e vendeve të Europës Juglindore, ku përfshihet edhe Bullgaria me Rumaninë, të cilat shfaqin rritje

³⁷ Gjatë regjimit komunist Shqipëria prishi gradualisht marrëdhëniet me aleatët e saj (Jugosllavia, BS dhe Kina) duke kaluar në një ekonomi autarkike. Ekstremizimi i këtij parimi arriti deri në ligjërimin në kushtetutë të ndalimit të marrjes së ndihmave dhe kredive nga vendet kapitalisto-revizioniste.

³⁸ Mbas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria trashëgoi tradita të pakta demokratike nga regjimi monarkik i mbretit Zog. Mbas fitores së komunizmit u vendos një diktaturë ekstreme dhe një regjim i cilësuar si i egër.

³⁹ Për më gjerë shih Pashko 1991. Rritja ekonomike e matur si rritje e produktit material neto ishte 44 për qind në vitet 1965-1975, 20 për qind në vitet '76-'80 dhe në më pak se 1 për qind në vitet '80.

⁴⁰ Për Shqipërinë si fillim konsiderohet viti 1991 (shih IMF, Occasional Paper, 184, 1999, Pashko, 1995).

⁴¹ Fillimet e tranzicionit e gjetën Shqipërinë si vendin më të varfër të Europës me standard jetese të krahasueshëm me vendet e botës tretë (Hadëri et al., 1999).

ekonomike jo të qëndrueshme.⁴² Ndërsa si viti i fillimit të tranzicionit konsiderohet viti 1991. Përkeqësimi i situatës ekonomike dhe rritja e presionit për ndryshime politike nga lëvizjet masive, në fundin e vitit 1990 dhe në fillimin e vitit 1991, çuan në ndryshime rrënjësore politike me zgjedhjet e para pluraliste, në mars të vitit 1991, të cilat u pasuan me një qeveri koalicioni që ndërmori reforma të vogla, që kishin të bënin me privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe me liberalizimin e çmimeve të mallrave të konsumit si edhe në përshtatjen e disa çmimeve të kontrolluara si ato të energjisë etj.⁴³

III. ECURIA MAKROEKONOMIKE GJATË TRANZICIONIT

III.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËN I STABILIZIMIT MAKROEKONOMIK

Megjithë zhvillimet minore reformuese të vitit 1991, reforma e plotë stabilizuese dhe strukturore filloi të zbatohet në mes të vitit 1992, pas fitores së forcave demokratike. Në Shqipëri u zbatua programi i stabilizimit, i mbështetur në paketën standarde, që konsiston në liberalizimin e çmimeve, në politikën fiskale që synonte balancimin e deficitit buxhetor, në politikën shtrënguese monetare nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare dhe në liberalizimin e tregtisë së jashtme duke siguruar konvertibilitetin e llogarisë korente. Paralelisht me paketën stabilizuese u ndërmorën reforma strukturore me privatizimin, rrjetin e mbrojtjes sociale, në sistemin e taksave dhe në atë financiar e bankar dhe me krijimin e kuadrit ligjor për një ekonomi tregu (FMN 1994). Zbatimi i kësaj pakete, në lidhje të ngushtë me mbështetjen e faktorit të jashtëm, veçanërisht të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, u kushtëzua nga kushtet konkrete të vendit tonë, së pari ato të nisjes, si dhe nga faktorë të tjerë politikë, të strategjisë së tranzicionit etj..

Si rezultat i stabilizimit makroekonomik dhe i reformave strukturore, Shqipëria provoi një ecuri makroekonomike stabël, me një rritje mesatare ekonomike prej 9 për qind në vit, në periudhën 1993-1996 dhe rreth 7.7 për qind në vit, në periudhën 1998-200 si dhe ulje të inflacionit nga 236 për qind në vitin 1992, në 4.2 për qind në

⁴² Shih Fisher and Sahay (2000), Havrylyshin Oleh et al (1999) dhe Muço (1994).


⁴³ Shih IMF, Occasional Paper, 184, 1999, Pashko, (1995). Kjo periudhë u karakterizua nga një përkeqësim i theksuar i llogarisë korente, si rezultat i rënies drastike të eksporteve dhe rritjes së ndjeshme të importeve veçanërisht për mallrat e konsumit; nga rritja e menjërshe e deficiteve buxhetore për shkak të kolapsit të sistemit të mbledhjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të detyruara shtetërore për subvencionet e pagave dhe ndërmarrjeve si dhe nga një rritje e ndjeshme e ekspansionit monetar (shih tabelë 1).

vitin 2000. Analiza e ecurisë makroekonomike në Shqipëri mund të bëhet duke ndarë tranzicionin në katër periudha kryesore sipas ecurisë së treguesve makroekonomikë, veçanërisht të rritjes së PPB dhe të inflacionit. (tabela 2 dhe grafiku 1.)

Periudha e viteve '91-'92, periudha e fillimit të tranzicionit, u karakterizua nga një rënie e madhe e PPB dhe inflacioni i lartë, përkeqësim i llogarisë korente dhe nga thellimi i deficitit buxhetor e tensione të forta sociale, që u shoqëruan edhe me shkatërrime të kapaciteteve prodhuese.

Në këtë periudhë, u ndërморën reformat e para që konsistonin në paketën stabilizuese, në reformat strukturore që filluan me privatizimin, krijimin e rrjetit të sigurimeve shoqërore dhe reformën e sistemit financiar dhe të taksave. Vetëm në mesin e vitit 1992 filluan të ndërmerren reformat e para stabilizuese dhe strukturore, që kishin të bënin me konvertibilitetin e plotë të llogarisë korente, me unifikimin e kurseve të këmbimit, me heqjen e kuotave nga tregtia e jashtme dhe me liberalizimin e shumicës së çmimeve, të cilat u thelluan gjerësisht në periudhën e dytë. Si rezultat i këtyre masave të para reformuese dhe i ndimës humanitare, ritmi i rënies u reduktua ndjeshëm nga -285 në -7 për qind, ndërsa inflacioni kërceu në nivelet më të larta të kësaj periudhe tranzicioni, në 236.6 për qind kryesisht si pasojë e liberalizimit të çmimeve në praninë e një norme të lartë të parasë gjithsej ndaj PPB-së prej 0.576, e cila është mbi normën (shih Bruno, 1992 dhe tabelë 1).

Grafik 1. Stabilizimi makroekonomik në Shqipëri, 1991-2000.



Periudha II ('93-'96) karakterizohet nga një rritje e ndjeshme ekonomike prej 9 për qind në vit, një rënie e inflacionit në nivel mesatar prej 17,5 për qind dhe nga një përmirësim i ndjeshëm i llogarisë korente dhe i deficitit fiskal, megjithëse në nivele mjaft të

larta. Kjo ecuri e mirë ishte pasojë e politikave të shtrënguara monetare dhe fiskale, të cilat kompensuan presionin inflacionist të liberalizimit të çmimeve dhe të privatizimit në bujqësi, në tregti me pakicë dhe shumicë, në ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, të cilat gjallëruan rritjen ekonomike. Gjatë kësaj periudhe, filloi dhe progresi privatizimi i tokës bujqësore, 93 për qind në fund të vitit 1993, filloi zbatimi i reformës së sistemit të taksave, filloi funksionimin tregu i bonove të thesarit dhe i privatizimit masiv me bono, ndërkohë që shumica e ndërmarrjeve të vogla u privatizua. Ndërkohë, u shënua një hap i ndjeshëm në pavarësinë e bankës qendrore me ligjin e ri të vitit 1996, që përcakton ruajtjen e stabilitetit të çmimeve si objektiv themelor të Bankës së Shqipërisë. Reforma e taksave progresoi me futjen e një takse të re, taksës së vlerës së shtuar-VAT.

Periudha III (1997). Kriza ekonomike dhe politike, e cila shpërtheu pas përmbysjes së skemave piramidale (por që në fakt kishte një bazë më të gjerë) çoi në rënie të prodhimit në masën 7 për qind, në rritje të inflacionit në masën 45 për qind dhe në keqësim të llogarisë korente dhe të deficitit fiskal. Qeveria e re zbatoi një program postkrizë të mbështetur edhe nga donatorët ndërkombëtarë si edhe thelloi më tej reformat strukturore, veçanërisht në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha si edhe të atyre strategjike. Për të reduktuar deficitin fiskal, duke rritur të ardhurat e buxhetit që ranë ndjeshëm si rezultat i krizës së thellë, qeveria rriti ndjeshëm VAT-in në 20 për qind duke kontribuar, për momentin, në rritjen e çmimeve.

Periudha IV ('98-2000). Është periudhë e ristabilizimit makroekonomik dhe e progresit të reformave strukturore, që lidheshin me thellimin dhe përfundimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe u hartua strategjia e privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha dhe të shërbimeve publike. Progres të rëndësishëm, në këtë periudhë, kanë shënuar edhe reformat e sektorit financiar që lidhen me privatizimin e bankave shtetërore dhe me hyrjet e bankave të reja private, të cilat kanë ndikuar në thellimin e ndërmjetësimit financiar dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve bankare. Stabilizimi i arritur dhe thellimi i reformave, çuan në një rritje të PPB-së në masën 7.7 për qind dhe në uljen të inflacionit në nivelin 3.9 për qind. Me gjithë përmirësimet në bilancin fiskal dhe të llogarisë korente ato mbetën në nivele negative relativisht të larta, përkatësisht -10.4 dhe 7.1 për qind të PPB-së.

III.2 INFLACIONI DHE STABILIZIMI

Rritja ekonomike lidhet, para së gjithash, me stabilizimin makroekonomik siç sugjerojnë edhe Fsieher et al. (1996) që "rritja kërkon stabilizimin dhe stabilizimi shpie në rritje". Sipas tyre, për inflacionin ekziston një "vijë e kuqe tej të cilës rritja nuk mund të jetë e qëndrueshme" dhe një prag inflacioni prej 50 për qind në mënyrë që të kemi rritje ekonomike dhe se reduktimi i inflacionit shoqërohet me rritje ekonomike të mëtejshme. Për Bruno and Easterly 1995, ky prag përcaktohet në nivelin e inflacionit prej 40 për qind. Analizën e stabilizimit makroekonomik dhe, veçanërisht, të inflacionit e hasim në një literaturë të bollshme të autorëve të huaj dhe vendas (**Pashko 1993, Domac and Elbirt 1998, McNeilly and Schiesser 1988, Hadëri et al 1999, Rother 2000 dhe Sadiraj 2000**).

Programet e stabilizimit, përgjithësisht, synojnë frenimin dhe uljen e inflacionit; rivendosjen e bilancit fiskal dhe përmirësimin e bilancit të jashtëm dhe mbështetin politika mikse fiskale, monetare dhe bilanc pagesash/kurs këmbimi. Politikat e kontrollit të fortë të rritjes së ofertës monetare dhe të rritjeve qeveritare janë tepër të rëndësishme për një inflacion të ulët. Gjithashtu, për një vend të vogël, të hapur, mbajtja e kurseve të këmbimit ndihmon për mbajtjen e çmimeve të mallrave të tregtueshëm në përputhje me çmimet e jashtme.

III.2.1. Politika monetare

Në fillimet e tranzicionit, rritja e shpejtë e kreditit për qeverinë në ndërmarrjet shtetërore, çoi në një zgjerim të madh monetar, i cili ndihmoi në rritjen e inflacionit të lartë. Në mesin e vitit 1992, u ndërmorën reforma të rëndësishme në fushën bankare, të cilat konsistuan në krijimin e Bankës së Shqipërisë si një bankë e re qendrore dhe në transferimin e operacioneve tregtare në Bankën Kombëtare të Shqipërisë. Bankës së Shqipërisë iu dha një pavarësi, e cila erdhi duke u zgjeruar, duke rezultuar me një rëndësi të veçantë për zbatimin e një programi të plotë stabilizimi.

Që në fillim, para autoriteteve shqiptare shtrohej problemi i zgjedhjes së ancorës nominale për programin e tyre disinflacionist midis stabilizimit të mbështetur në para dhe stabilizimit të mbështetur në kursin e këmbimit. Në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera të Europës Juglindore, u zgjodh regjimi fleksibël i kursit të këmbimit për disa arsye; mungesa e rezervave valutore

për të mbështetur një kurs të fiksuar dhe paaftësia për të vlerësuar normën me të cilën valuta vendase do të fiksohej. (FMN 1994, Sadiraj 2000.) Kontrolli i pagave dhe i kreditit shërbyen, gjithashtu, si ankora nominale në programin e stabilizimit, gjë që është në pajtim me pikëpamjen e Sahay dhe Vegh (1995), se një ancorë e pagës nominale është me rëndësi të veçantë për suksesin e programeve të stabilizimit, të mbështetura në parane, në vendet në tranzicion.

Në zbatimin e politikës monetare me synim frenimin e inflacionit dhe nxitjen e rritjes ekonomike, Banka e Shqipërisë zgjodhi si objektiv të ndërmjetëm bazën monetare dhe si instrumente të kontrollit monetar, kufirin e kredisë dhe vendosjen e normës së interesit për depozitat me afat në bankat me kapital shtetëror. Nëpërmjet këtyre instrumenteve, Banka Shqipërisë imponoi kufizime buxhetore të forta për të kontrolluar rritjen e parasë dhe të kreditit. Ulja e subvencioneve, duke eliminuar subvencionet e ndërmarrjeve dhe një pjesë të subvencioneve për çmimet, çoi në rënien e tyre nga 20.3 për qind në gjysmën e parë të vitit 1992, në 2 për qind në vitin 1993, duke shënuar ulje të mëtejshme deri në nivelin 0.4 për qind në vitin 1999 (Fondi Monetar Ndërkombëtar 1994). Gjithashtu, për ndërmarrjet shtetërore u vendos një sistem i kontrollit të rreptë të kreditit.

Të gjitha këto masa, çuan në rënien e rritjes monetare nga 182 për qind në vitin 1982, në 45 për qind në mesin e vitit 1993 dhe 42 për qind në vitin 1994. Nga ana tjetër, rritja e bilanceve reale të parasë në mënyrë të qëndrueshme deri në vitin 1996, ishte shenjë e rritjes së kredibilitetit të programit të stabilizimit duke treguar që pritjet inflacioniste të publikut kishin rënë dhe njerëzit ishin të gatshëm të mbanin më shumë para. Shpejtësia e parasë gjithsej, pas rritjes fillestare nga 1.9 në vitin 1993, në 2.6 në vitin 1994⁴⁴, ra në mënyrë të qëndrueshme duke treguar më tej se rritja e ekonomisë po shoqërohej me një rënie të pritjeve inflacioniste dhe me rritje të kredibilitetit të programit të stabilizimit. Kredibiliteti i politikës stabilizuese u rrit edhe për shkak të zbatimit të një politike fiskale të kombinuar dhe shumë të shtrënguar. Mungesa e tregut të letrave me vlerë bëri që qeveria të financohet direkt nga banka qendrore duke rritur ofertën monetare, e cila varet, para së gjithash, nga madhësia e deficiteve fiskale. Kjo konfirmohet edhe nga studimet e bëra (Domac dhe Elbirt, 1998) ku krediti për qeverinë dhe oferta e parasë rezultojnë si variabla të rëndësishëm në përcaktimin e inflacionit.

⁴⁴ Shih Hadëri et al 1999.

Përshatja e normave të interesit, si instrument i politikës monetare, luajti një rol të rëndësishëm në stabilizimin e inflacionit duke nxitur depozitimet dhe duke krijuar mundësinë që normat reale të bëheshin pozitive shumë shpejt, që në vitin 1993. Rilaksimi i politikës monetare, e cila u kushtëzua nga krijimi i skemave piramidale dhe nga rritja e shpenzimeve buxhetore, për shkak të fushatës elektorale, çoi në rritjen e inflacionit në fund të vitit 1996. Interesat që ofroi tregu informal ishin kaq të lartë sa që e nxorën, pothuajse jashtë loje, politikën monetare. Kriza e rëndë e vitit 1997, e shoqëruar me anarki totale, çoi në humbjen e besimit të publikut dhe në rrjedhjen e depozitave bankare si edhe në rritjen e financimit të deficitit buxhetor nga Banka e Shqipërisë. Për pasojë, niveli i inflacionit në fundin e vitit 1997 arriti në shifra të larta, me 42.1 për qind. Politikat stabilizuese të pasvitit 1998, pasuan fillimisht rritjen e normave të interesit dhe pas reagimit të shpejtë dhe të drejtë të publikut, të cilat shumë shpejt çuan në një ulje të ndjeshme të inflacionit në nivelin 8.7 për qind, në fundin e vitit 1998. Me uljen e theksuar të tij, madje në nivele negative, në vitin 1999, kemi një zbutje të politikës monetare duke ulur ndjeshëm normat e interesit. Në këtë periudhë, evoluon edhe instrumentet e politikës monetare, ku roli i kufirit të kreditit ra ndjeshëm derisa u shua si instrument, në vitin 1999, duke përdorur vetëm normën e interesit të depozitave, e cila shumë shpejt u zëvendësua vetëm me instrumentet e tregut, ku instrumenti kryesor është norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes.

III.2.2. Politika fiskale


Ulja e deficitit buxhetor përbën një faktor tjetër kyç për një stabilizim të suksesshëm. Ishte kjo arsyeja, që autoritetet fiskale synuan mbajtjen nën kontroll dhe uljen e deficitit, që në fillimet e tranzicionit. Duke kufizuar shumë elemente të shpenzimeve, përfshirë edhe pagat dhe sigurimet shoqërore. Shkurtimi i ndjeshëm i punonjësve të sektorit shtetëror, çoi në rënie të shpenzimeve për pagat, e cila u shoqërua edhe me rënie të pagës reale, në vitin 1992 (tabelë 9) dhe rritje të lehta të saj deri në vitin 1996. Gjithashtu, qeveria hoqi kontrollin mbi pagesat e sigurimeve shoqërore duke krijuar një sistem të ri, i cili shtrëngoi kriteret e pagesave duke kufizuar përfitimet nga papunësia deri në një vit. Nga ana tjetër, vendosja e ligjeve të reja të taksave zëvendësoi sistemin e vjetër të taksave të diferencuar, me një sistem të ri uniform për taksën e fitimit të ndërmarrjeve. Gjithashtu, vendosja e aksizave dhe e taksës së qarkullimit, duke përmirësuar administrimin fiskal gjeneroi të ardhura në rritje që përmirësuan

deficitin fiskal nga 20.4 për qind në vitin 1992, në 10.3 për qind në vitin 1995⁴⁵. Rritja e shpenzimeve shtetërore në prag të fushatës elektorale të vitit 1996 dhe rilaksimi i mbledhjes së taksave, rritën deficitin buxhetor në nivelin 12.9 për qind në fund të vitit 1996, nivel që u ruajt edhe në vitin e krizës, 1997. Programi postkrizë synoi përsëri uljen e deficitit, nëpërmjet rritjes së nivelit të të ardhurave, duke përsosur më tej legjislacionin tatimor dhe administrimin fiskal, duke çuar deficitin buxhetor në nivelin 9.1 për qind në vitin 2000. (Ministria e Financave).

III.2.3. Kursi nominal i këmbimit dhe burimet e jashtme

Kursi nominal i këmbimit përbën një komponent të rëndësishëm të programeve të suksesshme të stabilizimit. Shqipëria, për arsyt e përmendura, zgjodhi sistemin e kurseve fleksibël. Pesha, relativisht e lartë, e mallrave të importit në shportën e konsumit, me rreth 30 për qind, e bën vlerësimin dhe zhvlerësimin e kurseve të këmbimit, një faktor të rëndësishëm të luhatjeve të nivelit të çmimeve të mallrave të importit dhe nëpërmjet tyre, të nivelit të CPI. Studimet e kryera (Domac dhe Elbirt 1998, Maçellari et al 1997, Mytkolli dhe Hadëri) tregojnë për lidhjen pozitive midis nivelit të inflacionit dhe kurseve nominale të këmbimit, gjatë periudhës 1993-1997. Empirikisht, studimet vërtetojnë një përshtatje me një periudhë vonesë prej një muaji, të ndryshimeve në kursin e këmbimit në nivelin e inflacionit (grafik 2).

Grafik 2. Kurset nominale të këmbimit dhe inflacioni në Shqipëri, 1993-2000⁴⁶.



Përkundrejt përkeqësimit të madh të llogarisë korente që në fillimet e tranzicionit, që e ka bazën tek përkeqësimi i bilancit tregtar,⁴⁷

⁴⁵ Vlerësime të statistikave të Ministrisë së Financave dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

⁴⁶ vdlx1 përfaqëson ndryshimin midis dy periudhave të logaritmit të kursit të këmbimit me një hap vonesë, ndërsa dlx2 është ndryshimi midis dy periudhave të logaritmit të CPI.

Ilogaria korente është përmirësuar ndjeshëm për shkak të të ardhurave në formën e transfertave private dhe zyrtare, duke arritur nga 14 për qind e PBB-së në vitin 1994, në 7 për qind në vitin 2000 (Banka e Shqipërisë). Stabiliteti relativ i kurseve të këmbimit veçanërisht në vitet '93-'96 dhe '98 –2000 në një masë të madhe, i atribuohet dërgesave të emigrantëve, të cilat kanë ardhur gjithnjë në rritje duke kapur shifrën 439 milionë dollarë në vitin 2000 (Banka e Shqipërisë). Kjo konfirmohet edhe nga gjetjet empirike që tregojnë lidhjet negative midis dërgesave të emigrantëve dhe nivelit të inflacionit (Hadëri et al).

IV. FAKTORËT E RITJES GJATË TRANZICIONIT EKONOMIK

Analiza e faktorëve të rritjes në vendet e tranzicionit, përmbledh një varg të gjerë studimesh (Fischer et al, 1996 dhe 1998, EBRD 1997,) të cilat përfshijnë në modelet që përdorin, faktorë të tillë si kushtet e nisjes, inflacioni, teprica buxhetore, indeksi i reformave strukturore, rritja e popullsisë, norma e regjistrimit në arsimin e mesëm dhe niveli i investimeve ndaj PBB-së. Nga gjetjet empirike të studimeve të ndryshme, ekziston një marrëveshje, pothuajse e plotë, që stabilizimi përbën një kusht për gjallërimin dhe rritjen e produktit. Së dyti, pavarësisht nga kundërshtitë, pranohet se liberalizimi dhe reforma strukturore janë të rëndësishme për rritjen. Së treti, institucionet dhe kushtet si, rregullat e ligjit, korrupsioni, drejtësia, ngarkesa e taksave, përbëjnë një faktor tjetër, jo kaq të matshëm sa të parët, por me rëndësi të madhe për rritjen. Së fundi, faktorët klasikë të teorisë së rritjes si investimet, puna dhe kapitali human përdoren më pak në modele, duke pasqyruar pikëpamjen se në periudhën afatshkurtër rritja ekonomike pas recesionit ka një natyrë të veçantë.


Mbështetur në idetë që gjenerohen nga studimet e cituara mund të jepen shpjegime të pranueshme për faktorët e rritjes në tranzicionin shqiptar. Stabilizimi makroekonomik dhe politikat e qëndrueshme shpjegojnë mjaft mirë rigjallërimin e shpejtë të produktit mbas rënies së fillimit të tranzicionit dhe mbas krizës së vitit 1997. Kushtet e pafavorshme të nisjes, që kushtëzuan rënien e thellë të PBB-së në fillimet e tranzicionit, përveç faktit që baza e ulët e nisjes e bën më të lartë rritjen kur ekonomia hyn në fazën e gjallërimit, u kompensuan nga efekti pozitiv i privatizimit, që ishte më i ndjeshëm në bujqësi, në shërbime dhe në ndërtim (grafik 3).

⁴⁷ Liberalizimi i tregtisë së jashtme, ndryshimet reformuese në partnerët tregtarë kryesorë dhe struktura e deformuar e industrisë shqiptare çuan në rënie drastike të eksporteve, ndërkohë që importet përbëjnë një burim të qëndrueshëm të mallrave të konsumit.

Qeverisja e keqe dhe reformat e paplota strukturore, sidomos në sektorin financiar, që çuan në trazirat vitit 1997 (tabelë 5) shpjegojnë destabilizimin dhe rënien në këtë vit.

Sipas një studimi të ekonomistëve përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rezulton se stabiliteti makroekonomik është faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen ku përfshihet edhe Shqipëria. Krahas këtij faktori, sipas rëndësisë së dhënë, për Shqipërinë rezulton pozitiv regjimi liberal tregtar, pozita gjeografike, gjallërimi nga një bazë shumë e ulët duke u përjashtuar nga privatizimi, investimet e huaja direkte, kërkesa e brendshme, reforma bankare dhe e taksave, mbajtja e nivelit të lartë të investimeve. (Havrylyshin et al 1999.)

Grafik 3. Shqipëria: PBB sipas origjinës 1990-2000.



V. ROLI I PROGRAMEVE MBËSHTETËSE TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR NË STABILIZIMIN MAKROEKONOMIK DHE NË PROGRESIN E REFORMAVE

Mbështetja e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe veçanërisht e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në hartimin dhe në zbatimin e reformave të tranzicionit, ashtu si në vendet e tjera të CEE, ka qenë komplekse dhe e një rëndësie dhe impakti pozitiv për Shqipërinë. Kjo mbështetje e realizuar nëpërmjet programeve të ndryshme si SBA dhe ESAF, përkatësisht ESAF1 dhe ESAF2, konsiston në tre aspekte themelore.

Së pari, nëpërmjet këshillimit për politikat . Në kushtet e një mungese njohurish dhe përvoja për ekonominë e tregut drejt të cilës do të ecej nëpërmjet reformave, nevoja për këshillim ekspertësh ishte e padiskutueshme. Po kaq e padiskutueshme ka qenë ndihma e stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, e cila me

evoluimin e tranzicionit u shndërrua në një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe periodik për hartimin dhe zbatimin e politikave, për arritjen dhe konsolidimin e stabilitetit makroekonomik dhe për përshpejtimin e reformave strukturore.

Së dyti, nëpërmjet programeve të asistencës teknike, që kanë ndihmuar përshtatjen e sistemeve monetare, fiskale, statistikore të kurseve të këmbimit sipas kërkesave të një ekonomie tregu. Në Shqipëri, fushat kryesore ku është përqendruar kjo asistencë kanë qenë politika dhe administrimi i taksave, kontabiliteti i bankës kombëtare, mbikëqyrja bankare, përmirësimet në statistikat monetare, fiskale, të të ardhurave kombëtare, të bilancit të pagesave dhe të çmimeve.

Së treti, mbështetja financiare nëpërmjet programeve SBA dhe ESAF (tabelë 9). Analiza e programeve mbështetëse të Fondit Monetar Ndërkombëtar nga pikëpamja e projeksioneve dhe e zbatimit të tyre, rezulton se vendet me zbatim më të suksesshëm të programeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, kanë arritje më të mira makroekonomike, stabilizim më të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike. Niveli më i lartë i këtij indeksi për vendin tonë, në krahasim me grupin e vendeve të SEE, konfirmon këtë gjetje.⁴⁸

KONKLUZIONE

Stabilizimi i suksesshëm makroekonomik, megjithë luhatjet e tij ka në themel liberalizimin e shpejtë dhe të plotë të çmimeve, reformat strukturore veçanërisht privatizimin e tokës bujqësore dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, politikat e shtrënguara monetare dhe fiskale dhe transfertat zyrtare e private nga jashtë, të cilat ndihmojnë stabilitetin relativ të kurseve të këmbimit.

Pavarësisht nga ritmet relativisht të larta, rritja ekonomike në Shqipëri nuk ka qenë e qëndrueshme (në vitin 1997 –7.0 për qind) dhe vetëm në vitin 2000, niveli i PBB-së reale e kaloi atë të vitit 1989 në masën 102 për qind të nivelit të vitit 1989)⁴⁹. Në këto ritme ka ndikuar baza e ulët e krahasimit, arritjet në stabilizimin makroekonomik dhe reformat strukturore, veçanërisht në

⁴⁸ Lidhja pozitive mund të pasqyrojë edhe nivelin e lartë të angazhimit të autoriteteve në zbatimin e politikave për stabilizimin makroekonomik dhe reformat strukturore. Kjo vërtetohet edhe nga të dhënat statistikore, që tregojnë për një lidhje midis indeksit të zbatimit të reformave dhe rritjes ekonomike. (Havrylyshin Oleh et al 1999.)

⁴⁹ EBRD: Transition report update, April 2001.

privatizim. Sidoqoftë, ato lidhen më shumë me një rritje ekstensive të prodhimit.

Deficiti buxhetor është ende mjaft i lartë (9.1 për qind në vitin 2000) ndërsa borxhi i jashtëm në % ndaj PBB-së megjithëse, në ulje që nga viti 1994 (52 për qind) mbetet i lartë (28 për qind në vitin 2000). Ndërkohë, borxhi i brendshëm ka ardhur në rritje, nga 25.1 për qind në vitin 1995, në 34 për qind të PBB-së në vitin 1999.

Kurset e këmbimit valutor megjithë stabilitetin relativ, janë të luhatshëm, për shkak të bilancit të thellë tregtar, duke ndikuar në qëndrueshmërinë e nivelit të çmimeve. Studimet e deritashme provojnë lidhjen e fortë të inflacionit me kurset e këmbimit valutor. Deficiti i theksuar i bilancit tregtar shprehet edhe në varësinë e financimit të importeve nga burime të jashtme. Në vitin 2000, dërgesat e emigrantëve zënë rreth 40 për qind të importeve.

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një shkallë e lartë e pjesës informale, e cila vlerësohet nga 30 në 50 për qind e PBB-së (Banka e Shqipërisë) dhe e ka bazën kryesisht në dobësitë institucionale. Pavarësisht nga efektet stabilizuese afatshkurtra, siç tregojnë përvoja e tranzicionit shqiptar, ajo pengon ekonominë formale, deformat tregun dhe shtrembëron sinjalet alokuese që jep ai, nxit korrupsionin, frenon përparimin teknik, duke sjellë veçanërisht efekte negative afatgjata.

VI. KONSOLIDIMI MAKROEKONOMIK DHE SFIDAT E TË ARDHMES

Suksesi i arritur në fushën makroekonomike është sa i dukshëm aq i brishtë. Konsolidimi i tij dhe qëndrueshmëria afatgjatë kërkojnë përballimin e sfidave afatshkurtra dhe afatgjata, që lidhen me konsolidimin fiskal, me rritjen e efektivitetit të politikës monetare dhe me qëndrueshmërinë e çmimeve, me thellimin e reformave strukturore dhe institucionale, veçanërisht në privatizimin e sektorëve strategjikë të ekonomisë, të zhvillimit të sektorit financiar, të ruajtjes dhe zhvillimit të kapitalit human dhe të forcimit të qeverisjes

VI.1 KONSOLIDIMI FISKAL

Ulja e deficitit buxhetor dhe ruajtja e një norme të pranueshme dhe të qëndrueshme të borxhit publik, në kushtet kur ato ngelen në

nivele relativisht të larta, janë kusht i domosdoshëm i një konsolidimi fiskal afatgjatë. Ruajtja e një norme të qëndrueshme të borxhit kërkon që borxhi afatgjatë të mos rritet më shpejt se burimet e disponueshme që i shërbejnë atij. Konsolidimi fiskal është kusht për të siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme, por edhe pasojë e rritjes së qëndrueshme. Vetëm një rritje e qëndrueshme siguron rritje të ardhurash të buxhetit duke mbuluar shpenzime qeveritare në rritje dhe duke ulur deficitin buxhetor, i cili përbën premisë për uljen e borxhit publik.

Rritja ekonomike afatgjatë kërkon rritje të shpenzimeve për arsimin dhe shëndetësinë si dhe për investime publike. Edhe programet e qeverisë në sektorët kryesorë socialë, në kuadrin e investimit në kapitalin njerëzor dhe të uljes së varfërisë, do të mbështeten edhe nga politika fiskale. Rritja e shpenzimeve publike, në kushtet e thellimit të konsolidimit fiskal duhet të përballohet nga rritja e të ardhurave me ritme më të shpejta. Në kushtet e presionit dhe të nevojës për stimulimin e biznesit dhe të plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në OBT, të cilat kërkojnë mosrritje apo ulje të nivelit të taksave, rritja e të ardhurave kërkon përmirësim të administrimit fiskal dhe zgjerim të bazës së taksave.

VI.2 RITJA E EFEKTIVITETIT TË POLITIKËS MONETARE

Politika monetare, e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, do të vazhdojë të ketë si objektiv të saj ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Rritja e efektivitetit të politikës monetare nuk mund të arrihet pa përsosur mekanizmin e transmisionit, i cili kërkon përmirësimin e tregut financiar në përgjithësi dhe të atij të parasë dhe të kapitaleve në veçanti. Për të ulur koston e kredisë dhe rritjen e investimeve, Banka e Shqipërisë duhet të ushtrojë presion, nëpërmjet instrumenteve të saj të politikës monetare për uljen e diferencës midis normave të larta të interesit për kreditë dhe normave të interesit për depozitat.

VI.3 PËRMIRËSIMET INSTITUCIONALE DHE TË QEVERISJES

Një nga sfidat e tranzicionit shqiptar, e cila duhet të përballohet për të siguruar stabilizim dhe rritje afatgjatë është përmirësimi i institucioneve dhe i qeverisjes. Përvoja e tranzicionit tregon që qeverisja, krahas forcimit të saj është shumë larg të qenurit qeverisje e mirë për të mos thënë që, në shumë raste, është

dëshmuar si qeverisje e keqe⁵⁰. Qeverisja e keqe shpeshherë identifikohet me korrupsionin, por një qeverisje e mirë nënkupton më shumë se lufta kundër korrupsionit. Ajo përfshin, në rradhë të parë, vendosjen e një sistemi eficient ligjor, si bazat ligjore ashtu edhe zbatimin e ligjit që siguron ushtrimin e të drejtave individuale të pronësisë, duke inkurajuar aktivitete që sjellin rritjen ekonomike.⁵¹ Qeverisja e viteve të tranzicionit dhe institucionet, vuajnë nga zbatimi i dobët i ligjeve dhe i kontratave; nga mungesa e tregut të tokës dhe nga problemet e pronësisë mbi tokën; nga politikat e paqëndrueshme ekonomike lidhur me ndryshime të shpeshta të sistemit të taksave, të procedurave administrative etj.; nga dobësitë strukturore që lidhen me krizën energjitike dhe me infrastrukturën e transportit; nga shkalla e lartë e ekonomisë informale dhe konkurrenca e pandershme; nga rreziku i lartë i perceptuar nga biznesi dhe bankat; nga mungesa e transparencës dhe e informacionit dhe nga zbatimi i dobët i standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit.

Aspekti më i përfolur, por dhe më pak i matur dhe i luftuar i qeverisjes së keqe që ka shoqëruar tranzicionin shqiptar ka qenë korrupsioni. Studimet e pakta në këtë fushë, flasin për nivele të ndryshme të formave të korrupsionit në hallka të ndryshme të administratës qendrore dhe lokale dhe në sistemin gjyqësor, që pengojnë zhvillimin e biznesit, rrisin kostot dhe konkurrencën e pandershme.⁵² Sipas një klasifikimi, Shqipëria renditet e 84-ta midis 99 vendeve, për nivelin e korrupsionit. (Raporti zhvillimit njerëzor 2000.) Nga ana tjetër, kapaciteti i sektorit publik për të realizuar funksionet e tij, rezulton i kufizuar nga mungesa e përgjegjshmërisë dhe kapaciteti i ulët institucional (World Bank 1998).

Shprehitë dhe kualifikimi i fuqisë punëtore, si faktorët afatgjatë të rritjes, përbëjnë një burim të rëndësishëm për ekonominë e vendeve në tranzicion (EBRD 1997) dhe në shumë modele të

⁵⁰ Për një trajtim më të hollësishëm shih GRPS (2001), World Bank, Albania Beyond the Crisis, 1998.

⁵¹ Sipas Dhonte dhe Kapur 1977 dhe Johnson 1977, qeverisja e mirë përfshin mbajtjen e një stabiliteti të arsyeshëm ekonomik, ligje dhe rregulla eficiente të zbatuara jo në mënyrë diskriminuese me hapësira për ankim, veprimtari të parashikueshme, të qëndrueshme dhe të besueshme të qeverisë në fushën e rregullimit ekonomik, që lidhet me taksimin, licencat, monopolet natyrore, aktivitetet financiare.

⁵² Sipas pyetësorit të organizuar nga ACER (1998) rezulton se 15 për qind e qytetarëve paguajnë ryshfete për sigurimin e shërbimeve bazë nga organet shtetërore, 40 për qind paguajnë ryshfete për shërbimin mjekësor, ndërsa sipas Çipit (2001) rreth 60 për qind e qytetarëve paguajnë ryshfet për shërbimet mjekësore.

rritjes, autorë të ndryshëm, përdorin normën e regjistrimit në shkollën e mesme si variabël për matjen e tyre (Fischer et al 1996).⁵³ Megjithë nivelin e lartë që trashëgojnë vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, përfshirë Shqipërinë, në nivelin arsimor dhe në shprehjet e punës, duke i lidhur shprehjet dhe kualifikimin e punës me edukimin, mund të paraqiteshin tre tregues kryesorë që flasin për një prirje përkeqësuese të nivelit arsimor të popullsisë gjatë viteve të tranzicionit, e cila mund të minojë rritjen ekonomike në të ardhmen.

Së pari, norma e regjistrimit në vendin tonë ra ndjeshëm që në fillimet e tranzicionit, nga 90.8 në vitin 1989, në 87.6 në vitin 1994 (Ellman 2000), ndërsa në vitin 2000, vetëm 90 për qind e fëmijëve të moshës së shkollës ndjekin arsimin e detyrueshëm. Vetëm 82 për qind e fëmijëve që regjistrohen në klasën e parë përfundojnë arsimin fillor. Në krahasim me vitin 1990, niveli i regjistrimit në shkollë në vitin 2000 ka rënë për arsimin e mesëm me 36 për qind. 12 për qind e popullsisë mbi 15 vjeç nuk është në gjendje të shkruajë dhe të lexojë. (GPRS 2001). Rënia e nivelit të regjistrimit shfaqet edhe në rënien e zgjatjes mesatare të shkollimit nga 11,6 vjet në vitin 1989, në 9,5 vjet në vitin 1998 ndërkohë që, në krahasim me vitin 1990, ka rritje në numrin e studentëve që ndjekin shkollën e lartë, nga 10 në 17 për qind (World Bank, 2000).

Një tregues tjetër i rëndësishëm do të ishte niveli i shpenzimeve buxhetore për arsimin, i cili është mjaft i ulët me 3-4 për qind të PBB-së dhe 9-10 për qind të shpenzimeve shtetërore dhe çfarë është më keq është prirja rënëse e tij (shih tabelë 8).

Emigrimi i trurit, përbën treguesin e tretë përkeqësues të nivelit të kualifikimit të forcës punëtore në Shqipëri. Sipas disa studimeve të kryera, rezulton se deri në vitin 1999, 40 për qind e numrit të pedagogëve dhe të kërkuesve të universiteteve tona, kanë emigruar dhe rreth 63 për qind e të anketuarve dëshirojnë të emigrojnë. (Gëdeshi 1999.)

Për rrjedhojë, rritja e pjesëmarrjes në arsimin tetëvjeçar dhe të mesëm, rritja e cilësisë së personelit mësimor, rritja e shpenzimeve buxhetore për arsimin duke motivuar financiarisht punonjësit e sistemit të arsimit, veçanërisht të atij parauniversitar, përbëjnë sfida që nuk mund të neglizhohen për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme.

⁵³ Shih Fischer et al 1996 të dhënat empirike që rezultojnë nga testimi i ekuacionit të rritjes, të përdorur në këtë model duke marrë 26 vende në tranzicion, vërtetojnë rëndësinë e këtij variabli për rritjen afatmesme dhe afatgjatë.

Tabelë 1. Shqipëria: Tregues të përgjithshëm në fillim të periudhës së tranzicionit.

Popullësia (1991, mesatare vjetore) ¹	3,242,000
PBB për frymë (1991) ²	\$340.0
Rritja e PBB (mesatare vjetore, çmime konstante) ³	
Vitet '70	5.0%
Vitet '80	0.8%
Çmimet nën kontroll	100%
Spektori shtetëror i ekonomisë	Nëgjithë ekonominë
Paraja gjithsej/PBB ⁴	0.576
Borxhi i jashtëm/PBB (1991) ⁵	0.573

Tabelë 2. Treguesit makroekonomikë, 1991-2000 (mesataret vjetore në %).

	1991-1992	1993-1996	1997	1998-2000
Rritja reale e PBB-së	-17.6	9.3	-7	7.7
Inflacioni	170.5	17.5	42.1	3.9
Deficiti i llogarisë korente (% PBB)	-61.1	-15.1	-12.1	-7.1
Deficiti fiskal (% PBB)	-25.8	-11.4	-12.9	-10.4

Tabelë 3. Shqipëria : Ecuria makroekonomike, 1991-2000.

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Rritja reale e PBB-së	-28	-7.2	9.6	9.4	8.9	9.1	-7	8	7.3
Inflacioni	104.1	236.6	30.9	15.8	6	17.4	42.1	8.7	-1
Financimi i brendshëm i deficitit	-34.4	-20	-14.4	-12.4	-10.3	-12.9	-12.9	-10.4	-11.4
Deficiti fiskal (në % PBB)	-34.4	-20.4	-14.4	-12.4	-10.3	-12.9	-12.9	-10.4	-11.4
Të ardhurat (% të PBB-së)	32	23.5	25.7	24.5	24.1	18.3	16.9	20.3	21.3
Shpenzimet (në % PBB)	64	44	34.9	31.2	30.8	30.3	29.4	30.7	32.7
Norma e papunësisë (%)	8.9	27.9	29	19.6	16.9	12.4	14.9	17.8	18
Deficiti i llogarisë korente (% PBB)	-18.8	-14.7	-3.7	-5.9	-2.4	-6.2	-8.7	-3.2	-3.4
Deficiti i llogarisë korente (% PBB) ¹	-18.8	-61.1	-29.7	-14.1	-7.3	-9.1	-12.1	-6.1	-7.2
Bilanci tregtar/PBB (%)	-27.7	-64	-39.9	-23.2	-19.6	-25.7	-22.7	-20.4	-18
Rezerv ndërkomb. bruto (muaj importesh)		1.4	2.3	3.2	3.5	3.1	3.8	4.2	3.8
Rritja e parasë gjithsej (në %)	110	152.7	75	40.6	51.8	43.8	28.4	20.7	22.3
Rritja e kredisë për sektorin privat				61.4	15.9	30.5	19	14.7	22.6
Paraja gjithsej/PBB tremujore			3.68	2.83	2.22	1.97	1.92	1.92	1.73
Norma e interesit (depozita 3muajore)			14	7	10	18.5	26	20.4	14.8
Shpejtësia e qarkullimit			3.68	2.83	2.22	1.97	1.72	1.92	1.7
Kursi i këmbimit (lek/usd)	25	98.7	98.68	95.39	94.24	103.1	149.1	141	135

Borxhi/PBB (%)				52.5	55.5	59.9	71.4	59.4	62.2
I jashtëm		130.1	78.9						
Invest. e huaja direkte (milione USD)		20	45	65	89	97	42	45	51
PBB për frymë (në usd)		195	375	604	761	817	687	908	1122

Tabelë 4. PBB në Shqipëri sipas sektorëve.

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Prodhimi i brendshëm bruto	-10	-28	-7.2	9.6	8.3	13.3	9.1	-7	8	7.3	7.8
Industria	-14.2	-41.9	-51.2	-10	-2	6	13.6	-5.6	4.1	6.4	5
Bujqësia	-5.4	-17.4	18.5	10.4	8.3	13.2	3	1	5	3.7	4.5
Ndërtimi	-12	-30	7	30	15	21.2	18.4	-6.3	21	15	18
Shërbime të tjera	-8.4	-16.8	-6	29	29	32.2	19.2	-45	30	27	25
Prodhimi i brendshëm bruto	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Industria	39.8	32.1	16.9	13.9	12.5	11.7	12.2	12.4	12	11.9	11.5
Bujqësia	37	42.5	54.2	54.6	54.6	54.6	51.1	56	54.4	52.6	51
Ndërtimi	6.6	6.6	7.6	9.1	9.6	10.3	11.2	11.2	12.6	13.5	14.8
Shërbime të tjera	16.4	18.7	21.3	22.5	23.2	23.4	25.1	20.4	21	22	22.7

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabelë 5. Shqipëria: Treguesit kryesorë të tranzicionit 1991-2000.

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Indeksi i Berzh për liberalizimin e çmimeve	1.0	2.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0
Indeksi i Berzh për liberalizimin e tregtisë dhe kursit të këmbimit	1.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0
Indeksi i Berzh për privatizimin e ndërrmarjeve të vogla	2.0	2.0	3.0	3.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0
Indeksi i Berzh për privatizimin e ndërrmarjeve të mëdha	1.0	1.0	1.0	1.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0
Indeksi i Berzh për reformat në ndërrmarjet e mëdha	1.0	1.0	1.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0
Indeksi i Berzh për politikën për konkurrencën	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.7	1.7	1.7	1.7
Indeksi i Berzh për reformat në sistemin bankar	1.0	1.0	1.3	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0

Indeksi i Berzh për reformat në institucionet financiare jobankare	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.7	1.7	1.7	1.7
Të ardhurat nga privatizimi	Na	1.1	1.8	3.0	3.1	3.3	3.6	3.6	3.9
Pjesëmarrja e sektorit privat në PBB	5.0	10.0	40.0	50.0	60.0	75.0	75.0	75.0	75.0

Burimi: EBRD, Transition Report, 2000.

Tabelë 6. Shqipëria: Niveli i punësimit dhe pagave në institucionet buxhetore.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Punësimi (në mijë)	207.1	185.4	167.8	156	151	150	135	128.4	122.1
Paga mujore (në lekë)	1879	4738	6962	8745	10491	10491	13234	13195	15078
Ndryshimi në % i pagave		64.5	46.9	25.6	20	0	26.1	-0.3	14.3
Pagat reale (Dhjetor 95=100)	52.9	66.5	84.4	100	102.2	71.9	83.5	84.1	92.2
Ndryshimi në % i pagave reale		25.7	26.9	18.5	2.2	-29.6	16.1	0.7	9.7

Burimi : FMN dhe autoritetet shqiptare.

Tabelë 7. Shqipëria: PBB, Remitancat, 1994-2000.

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
PBB, çmimet korente (në miliardë lekë)	184.0	229.7	278.7	341.7	460.6	506.3	539.2
Remitancat (në milionë usd)	379.1	384.7	476.0	235.7	437.7	188.4	438

Burimi: 1. PBB: Vlerësime të FMN-së.

2. Remitancat: Banka e Shqipërisë, Statistikat tremujore.

Tabelë 8. Shqipëria : Marrëveshjet me FMN-në 1991-2000.

Marrëveshja (Shqipëria)	Data e aprovimit	Data zyrtare e përfundimit	Përqindja e blerjes nga kuota	Indeksi I implementimit të programeve të FMN-së*
SBA	26/8/92	25/8/93	52.5	Shqipëria -90.9
ESAF1	14/7/93	13/7/96	88.0	Bullgaria -50
ESAF2	13/5/98	31/7/2001		Rumania -76.6

Burimi : Statistika të FMN-së.